



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2018:015754

Datë: 19.12.2018

Numri i dokumentit: 00192105

**PKR.nr.30/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi me anëtarët e trupit – gjyqtarët: Kymete Kicaj dhe Luan Berisha, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarve N. A., D. B. dhe M. S. që të tre nga Prizreni dhe B. B. nga fshati ... Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1. lidhur me nenn 31 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së PSH në Prizren PP.nr.313/16 të datës 24.02.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarëve dhe mbrojtësve të tyre avokat S. M., A. H., B. N. dhe R. H. më datën 10.12.2018, muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**N. A.** nga i ati Q. dhe e ëma S. – e lindur S., i lindur më .... në fshatin ... Komuna e Prizrenit, me banim në Prizren në rrugën "...", PN, i martuar – i ati i katër fëmijëve, e ka të kryer shkollën e mesme, me profesion zyrtar policor i Kosovës, i gjendje së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovë, ka qenë në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 19.12.2016 gjerë më 24.03.2017.

**D. B.**, nga i ati Sh. dhe e ëma L. – e lindur L., i lindur më .... në Prizren ku edhe tani jeton, në rrugën "...", ..., e ka të kryer shkollën e mesme, me profesion zyrtar policor i Kosovës, i martuar – i ati i tre fëmijëve, i gjendje së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovë, ka qenë në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 19.12.2016 gjerë më 24.03.2017.

**M. S.** me nofkën “M.” nga i ati H. dhe e ëma Sh. –e lindur A., i lindur më ..... në fshatin .... Komuna e Dragashit, me banim në Prizren, në rrugën “.....” nr..., e ka të kryer shkollën e mesme, i martuar – i ati i katër fëmijëve, zyrtar policor i Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovë, ka qenë në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 19.12.2016 gjerë më 24.03.2017.

**B. B.**, nga i ati E. dhe e ëma V. – e lindur ....., i lindur më .... në fshatin .... Komuna e Malishevës, ku edhe tani jeton, e ka të kryer shkollën e mesme, i martuar – i ati i tre fëmijëve, me profesion zyrtar policor i Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 19.12.2016 gjerë më 24.03.2017.

### **JANË FAJTOR**

Se në vazhdimësi në intervale kohore të ndryshme prej datës 15.08.2016 e deri më datën 10.11.2016 në bashkëveprim mes vehte në cilësinë e personave zyrtar – policëve të trafikut rrugor rregjional në Prizren, në mënyrë të drejtëpërdrejtë kërkojnë dhe marrin për vehte ryshfet në të holla, duke vepruar në kuadër të autorizimeve zyrtare, ndërmarrin veprime në kundërshtim me Ligjin e komunikacionit rrugor, në atë mënyrë që gjatë patrullimit në mirëvajtjen e komunikacionit, me automjetin zyrtar të policisë së markës “Shkoda” me targa të regjistrimit POLICE xxx-xx të akuzuarit N. dhe D. më datën 15.08.2016 pasi ndalin në një pikë kontrolli në aksin rrugor në Duhël, kundërvajtësen A. B., e cila drejtonte automjetin e markës “Mercedes” me targa të Suedisë, i marrin shumën e të hollave prej 70 Euro, në vend që ti lëshojnë tiketë për shqiptimin e gjobës për kundërvajtjen e kryer,

më datën 24.09.2016 i akuzuari N. nga kundërvajtësi me emrin G. merr shumën prej 20 Euro, ndërsa nga kundërvajtësi me emrin N. merr shumën prej 50 Euro, në vend të shqiptimit të gjobës për kundërvajtjen e kryer,

më datën 09.09.2016 të akuzuarit N. dhe D. pasi ndalin në rrugë me automjet kundërvajtësin – shtetasin e Sllovakisë, nga ai kërkojnë dhe marrin shumën prej 100 Euro, në vend të shqiptimit të gjobës për kundërvajtjen e kryer,

më datën 03.10.2016 i akuzuari N. dhe B. nga kundërvajtësi me emrin B. marrin shumën prej 20 Euro, nga kundërvajtësi me emrin N. marrin shumën prej 20 Euro, në vend që ti shqiptojnë dënim me gjobë për kundërvajtje, ndërsa më datën 04.10.2016 nga kundërvajtësi me emrin A. marrin shumën prej 10 Euro për të mos i shqiptuar gjobë për kundërvajtjen e kryer,

më datën 19.10.2016 të akuzuarit D. dhe M. pasi ndalin në rrugë një kundërvajtës nga Shkupi, shtetas shqiptar nga i njëjti marrin shumën prej 10 Euro në vend të shqiptimit të gjobës për kundërvajtjen e kryer,

më datën 05.11.2016 i akuzuari N. pasi ndal në rrugë kundërvajtësin e paidentifikuar nga i njëjti merr shumën prej 10 Euro, më datën 10.11.2016 të akuzuarit M. dhe N. pasi që ndalin një kundërvajtës të paidentifikuar i cili me të akuzuarit komunikon në gjuhën serbe, nga i njëjti marrin shumën prej 10 Euro në vend të shqiptimit të dënimit me gjobë për kundërvajtjen e kryer.

-Këso dore në bashkëryerje kanë kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KP.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 4, 7, 17, 41,45,46 47,73,80,,83 dhe 428 p.1 lidhur me nenin 31 të KP i

## G J Y K O N

### Të akuzuarit:

**1.N. A.** me dënim me gjobë në shumën prej 4000/katërmijë/ Euro, si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 gjashtë/ muajve.

Konformë nenit 47 të KP me pëlqimin e të dënuarit dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtuqë konformë nenit 46 par.2. të KP i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 8000/tetëmjë/ Euro.

Konformë nenit 80 par.2.p.2.4. të KP të akuzuarit N. A. i shqiptohet **dënimi unik me gjobë në shumën prej 12.000/dymbëdhjetëmjë/ Euro**, në të cilin dënim me gjobë do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 19.12.2016 gjerë më 24.03.2017.

**2.D. B.** me dënim me gjobë në shumën prej 4000/katërmijë/ Euro, si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 gjashtë/ muajve.

Konformë nenit 47 të KP me pëlqimin e të dënuarit dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtuqë konformë nenit 46 par.2. të KP i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 8000/tetëmjë/ Euro.

Konformë nenit 80 par.2.p.2.4. të KP të akuzuarit D. B. i shqiptohet **dënimi unik me gjobë në shumën prej 12.000/dymbëdhjetëmjë/ Euro**, në të cilin dënim me gjobë do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 19.12.2016 gjerë më 24.03.2017.

**3.M. S.** me dënim me gjobë në shumën prej 4000/katërmijë/ Euro, si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 gjashtë/ muajve.

Konformë nenit 47 të KP me pëlqimin e të dënuarit dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtuqë konformë nenit 46 par.2. të KP i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 8000/tetëmjë/ Euro.

Konformë nenit 80 par.2.p.2.4. të KP të akuzuarit M. S. i shqiptohet **dënimi unik me gjobë në shumën prej 12.000/dymbëdhjetëmjë/ Euro**, në të cilin dënim me gjobë do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 19.12.2016 gjerë më 24.03.2017.

**4.B. B.** me dënim me gjobë në shumën prej 5000/pesëmijë/ Euro, si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 gjashtë/ muajve.

Konformë nenit 47 të KP me pëlqimin e të dënuarit dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtuqë konformë nenit 46 par.2. të KP i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 8000/tetëmijë/ Euro.

Konformë nenit 80 par.2.p.2.4. të KP të akuzuarit B. B. i shqiptohet **dënimi unik me gjobë në shumën prej 13.000/trembëdhjetëmijë/ Euro**, në të cilin dënim me gjobë do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës 19.12.2016 gjerë më 24.03.2017.

Obligohen të akuzuarit që konformë nenit 46 par.2. të KP dënimin me gjobë ta paguajnë në afat prej 15 ditëve, pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konformë nenit 46 par.3. të KP, nëse dënimin me gjobë nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë në afatin e paraparë gjykata do ta zëvendësoi dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtuqë një ditë burgim do t'iu llogaritet me 20 Euro gjobë.

Obligohen të akuzuarit që konform Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit, secili prej tyre të paguajnë shumën me nga 50 Euro, për programin e kompenzimit të viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Obligohen të akuzuarit që secili prej tyre në emër të paushalit gjyqësor të paguajnë shumën me nga 500 Euro, në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

## A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr.313/16 të datës 24.02.2017 kundër të akuzuarve N. A., D. B., M. S. dhe B. B., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale marrja e rryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KP.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit Mehdi Sefa ka ngel në tërësi pranë fjalës përfundimtare të datës 31.10.2017, duke cekur se edhe gjatë rigjykimit tre të akuzuarit e parë e kanë pranuar fajsinë, ndërsa pas administrimit të provave dhe eliminimit të vërejtjeve të gjykatës së apelit është vërtetuar se edhe i akuzuari B. B. ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv. Në veqanti pas video inqizimit të aplikuar përmes masave të fshehta është vërtetuar se ditën kritike me datën 03.10.2016 ka qenë në patrollim me këtu të akuzuarin N. A. dhe qartë shihet se B. B. ka marr nga kundërvajtësi 20 euro duke mos i shqiptuar tiketë kundërvajtësit dhe 20 euro i vendos në kasetofonin e automjetit zyrtar. Andaj, edhe në veprimet e tij janë formuar elementet e veprës penale si bashkëkryerës të marrjes së rryshfetit nga neni 428 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KP, ashtuqë ka propozuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit N. A., avokat S. M. ka theksuar se pasiqë i akuzuari që nga fillimi i procedurës e ka pranuar fajsinë, ka propozuar që gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, se është babë i katër fëmijëve, i papunë, pendimin e thellë, mungesën e pasojave të rënda, andaj ka propozuar që ti shqiptohet një dënim sa më i lehtë. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe vet i akuzuari N. A.

Mbrojtësi i të akuzuarit D. B. avokat A. H. fjalën përfundimtare e ka dorëzuar në formën e shkruar dhe se gjatë elaborimit ka deklaruar se i mbrojturi i tij D. B. e ka pranuar fajsinë dhe se kjo padyshim që trupin gjykues duhet ta bindë se i mbrojturi i tij është penduar për veprimet e kryera si dhe jep garanci që në të ardhmen i njëjti nuk do të përsërisë veprime inkriminuese. Andaj, ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit ti aplikoi dispozitat për zbutjen e dënimit dhe të ia shqiptoi një dënim nën kufirin minimal të paraparë ligjor, pasi që edhe me një dënim më të ultë apo lloj tjetër të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari D. B.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. S. avokat B. N. ka theksuar se në rastin konkret kemi të bëjme me pranimin e fajësisë që nga fillimi i procedurë, andaj ka kërkuar që gjykata ta ketë parasysh këtë fakt me rastin e shqiptimit të dënimit. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe vet i akuzuari M. S.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. B. avokat R. H. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar në formën e shkruar të cilën edhe e ka elaboruar gojarisht duke cekur se me asnjë provë të sigurt nuk është vërtetuar se i akuzuari B. B. gjatë ushtrimit të detyrës së tij si polic i komunikacionit rrugor nga kundërvajtësit të ketë kërkuar apo marrë ryshfet. Prokurori i shtetit në fjalën e fundit aktakuzën e mbështet vetëm në një provë – në video – audio inqizim të datës 03.10.2016 prej orës 19:27,05 sekonda. Nga video-audio inqizimi në CD të shiquar ka qenë e pamundur të konstatohet saktë dhe sigurt se polici i ulur në ulësen e majtë ka qenë i akuzuari B. B.. Poashtu, nuk shihet qartë se B. B. nga i ka marrë këto të holla në vlerë prej 20 Euro dhe momenti i vendosjes së tyre afër radios. Në lidhje me dispozitat e neneve 88 par.1. dhe 91 par.1. të KPP që ka të bëjë me urdhëresat për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit në mënyrë detale bëhet fjalë në fjalën e fundit të mbrojtësit të mëparshëm avokat R. K. Andaj, nisur nga këto fakte mbrojtja konsideron se i akuzuari B. B. nuk ka kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1. të KP andaj, ka propozuar që gjykata të marrë aktgjykim lirues konformë dispozitave të nenit 364 par.1.p.3. të KPP. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari B. B.

Duke marrë parasysh që i akuzuari B. B. gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1. lidhur me nenin 31 të KP-së, gjykata ka administruar provat e propozuara sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit dhe ate ka bërë leximin e orarit ditor të punës së Drejtorisë Rajonale të Policës për datën 03.10.2016, raportit të patrullës së njësisë Rajonale të datës 03.10.2016, orarit ditor të punës dhe raportit të patrullës, që të dyja të datës 04.10.2016, ka bërë shiqimin në kopjen e librit të tiketave, leximin e transkripteve të datës 03.10.2016 dhe 04.10.2016, si dhe shiqimin në video dhe audio inqizim të CD-së të dt. 03.10.2016 dhe poashtu ka marrë në pyetje të akuzuarin B. B.

Nga provat e administruara të lartëcekura-orari ditor vërtetohet fakti se me datën 03.10.2016 njësia Rajonale e komunikacionit rrugor – Policët B. B. dhe N. A. kanë qenë së bashku në patrullim në veturën xxx-xx prej orës 15:00 deri më 23:00. Ndërsa nga raporti i patrullës i datës së njëjtë vërtetohet se këtu të akuzuarit B. B. dhe N. A. kanë qenë në pika kontrolli në fshatin Duhël – Suharekë prej orës 16:30. deri me 19:30, ndërsa në fshatin Shirokë të Suharekës prej orës 20:45 gjer më 22:00, kanë shqiptuar 16 tiketa, kanë ndaluar 23 automjete dhe kanë kontrolluar 2 automjete.

Nga orari ditor i punës i datës 04.10.2016, poashtu vërtetohet se këtu të akuzuarit B. B. dhe N. A. kanë qenë së bashku në patrullim me veturën xxx-xx prej orës 15:00 deri më 23:00.

Nga raporti i patrullës i datës 04.10.2016 vërtetohet se të akuzuarit e lartëcekur kanë qenë prej orës 16:05 deri në ora 19:00 në pikë kontrollin në fshatin Duhël Suharekë, ndërsa prej orës 20:10 deri në ora 21:00 në fshatin Shirokë të Suharekës, kanë shqiptuar 10 tiketa, kanë bërë 2 fletëparaqitje, i kanë ndaluar 20 automjete dhe kanë kontrolluar 2 automjete. Nga libri i tiketave nuk është vërtetuar se është paguar ndonjë tiketë në emër të kundërvajtësit B.

Nga transkriptet e aplikimit të masave të fshehta të datës 03.10.2016, rreth orës 17:40:40 vërtetohet se nga kundërvajtësi me emrin B. të akuzuarit N. A. dhe B. B. marrin 20 Euro.

Nga transkriptet e aplikimit të masave të fshehta të datës 03.10.2016, rreth orës 19:27:27 vërtetohet se kundërvajtësi me emrin N. ia zgjat një kartmonedhë prej 20 Euro zyrtarit policor të ulur tek ulësja e vozitësit i cili atë kartmonedhë e vendos tek një dollap afër radios së veturës.

Nga transkriptet e bisedave nga aplikimi i masës së fshehtë për datën 04.10.2016, që kemi të bëjmë me kundërvajtësin A. në ora 17:40:33, vërtetohet se kundërvajtësi i jep 10 Euro zyrtarëve policor.

Me shiqimin në video inqizimin e datës 03.10.2016, rreth orës 19:27:27 vërehet këtu i akuzuari N. A. dhe i akuzuari B. B., i cili nga një kundërvajtës derisa ka qenë i ulur mbrenda në veturë në ulësen e vozitësit merr shumën e të hollave prej 20 Euro dhe i vendos në një dollap afër radios së veturës dhe se kundërvajtësit nuk i japin asnjë dokument lidhur me gjobën apo me marrjen e parave.

I akuzuari B. B. në mbrojtjen e vet gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 23.10.2018 ka deklaruar se ngelë pjesërisht pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e datës 31.10.2017, e konteston datën 03.dhe 04.10.2016 duke cekur se nuk është i sigurt që me ato data ka qenë në punë dhe se nëse ka qenë me kend ka qenë. Poashtu, ka mohuar në tërësi se më datën 03.10.2016 nga kundërvajtësi me emrin B. ka marrë 20 Euro, nga kundërvajtësi me emrin N. poashtu ka mohuar të ketë marrë 20 Euro si dhe më datën 04.10.2016 ka cekur se nuk është e vërtet që nga kundërvajtësi me emrin A. ka marrë shumën prej 10 Euro. Gjithashtu e ka mohuar faktin duke cekur se nuk është i sigurt që ai është personi në video-inqizimin e shiqur gjatë shqyrtimi gjyqësor.

Në bazë të provave të lartëcekura, pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, gjykata ka vërtetuar se këtu i akuzuari është bashkryerës i veprës penale të marjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KP. Nga fakti se kjo është vërtetuar nga provat e lartëcekura materiale, andaj edhe mbrojtja e të akuzuarit – të cilës gjykata nuk ia fali besimin, se me datat 03 dhe 04.10.2016 nuk është i sigurt që ka qenë në punë dhe nëse ka qenë me kend ka qenë, janë të pabaza dhe në kundërshtim me provat e lartëcekura materiale pasi që kjo është vërtetuar nga orari ditor se me datën 03.10.2016 njësia Rajonale e komunikacionit rrugor – Policët B. B. dhe N. A. kanë qenë së bashku në patrullim në veturën xxx-xx prej orës 15:00 deri më 23:00. Ndërsa nga raporti i patrullës i datës së njëjtë vërtetohet se këtu të akuzuarit B. B. dhe N. A. kanë qenë në pika kontrolli në fshatin Duhël – Suharekë prej orës 16:30. deri me 19:30, ndërsa në fshatin Shirokë të Suharekës prej orës 20:45 gjer më 22:00. Poashtu nga orari ditor i punës i datës 04.10.2016, vërtetohet se këtu të akuzuarit B. B. dhe N. A. kanë qenë së bashku në patrullim me veturën 032-06 prej orës 15:00 deri më 23:00. Nga raporti i patrullës i datës 04.10.2016 vërtetohet se të akuzuarit e lartëcekur kanë qenë prej

orës 16:05 deri në ora 19:00 në pikë kontrollin në fshatin Duhël Suharekë, ndërsa prej orës 20:10 deri ne ora 21:00 në fshatin Shirokë të Suharekës.

Fakti se i akuzuari B. B. në datat kontestuese ka qenë së bashku me N. A., është vërtetuar edhe nga transkriptet e aplikimit të masave të fshehta si dhe nga video-inqizimi i shiquar, ku shihet i akuzuari B. B. së bashku me të akuzuarin N. A.

Konformë nenit 428 par.1. të KP personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vehte ose personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar të veproi ose të mos veproi në pajtim me detyrën e tij zyrtare kryen veprën penale të marrjes së ryshfetit dhe dënohet me gjobë dhe me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjetë. Në rastin konkret gjykata ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni i lartëcekur pasi që ai në mënyrë të drejtëpërdrejtë kërkon dhe pranon përfitim – shumën e të hollave nga kundërvajtësit e lartëcekur në vend të shqiptimit të dënimit me gjobë për kundërvajtjen e kryer.

Personi zyrtar nuk mundet që për kryerjen e punëve zyrtare të kërkojë apo të marrë dhuratë apo dobi e aqë më tepër nuk mundet që në lidhje me këtë të ndërmerrë veprimet e kundërligjshme, respektivisht të përmbahet nga kryerja e ligjshme e detyrave zyrtare. Në rastin konkret i akuzuari B. B. ka kërkuar të holla për mos kryerjen e një veprimi-mos lëshimit të tiketave kundërvajtësve, përkundër faktit që ka qenë i detyruar ta bëjë këtë. Duke marrë parasysh faktin se kjo vepër penale kryhet me dashje, gjykata edhe ka gjetur se këtu i akuzuari ka kryer veprën penale të lartëcekur pasi që tek i njëjti ka ekzistuar vetëdija mbi kërkesën – marrjen e dhuratës – të hollave si dhe vetëdija për natyrën e kryerjes së veprimeve zyrtare-mos kryerjes së veprimeve zyrtare me ç rast kërkohet – mirret ryshfet, pasi që personi zyrtar nuk mundet që për punën e vet të cilën e kryen në kuadër të vendit të vet të punës, përpos kompensimit të caktuar me ligj – pagës, të marr nga subjekti tjetër kompensim.

Andaj, duke marrë parasysh të lartëcekurat gjykata këtu të akuzuarin B. B. e shpalli fajtor për veprën penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1. lidhur me nenin 31 të KP dhe të njejtit ia shqiptoi dënimin unik me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pohimeve të avokatit mbrojtës se masat e fshehta duhet të shpallen prova të papranueshme sa i përket të akuzuarit B. B., janë të pabaza nga fakti se informacionet dhe të dhënat e siguruara në kuadër të masave teknike të vëzhgimit dhe hetimit mund të shfrytëzohen si provë edhe ndaj personave të tretë si bashkëveprues me personin ndaj të cilit janë urdhëruar. Të dhënat dhe informacionet e marra në masat e mshefta, mund të përdoren si provë në procedurën penale edhe kundër personave të tretë – personave ndaj të cilëve nuk janë caktuar masat e mshefta, nëse kanë të bëjnë me vepër penale për të cilën janë caktuar të njëjtat, nëse ky person i tretë është bashkëkryerës për veprën penale për të cilën janë caktuar masat, ose ky person i tretë është kryerës i veprës penale e cila është në lidhje të drejtëpërdrejtë me veprën penale për të cilën janë caktuar masat. Duke marrë parasysh faktin që ka ekzistuar urdhëresa e lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake për të akuzuarin N. A. për datat 03.dhe 04.10.2016, e që me provat e lartëcekura është vërtetuar se këtu i akuzuari ka qenë së bashku me të akuzuarin N. A., e duke marrë parasysh që për të akuzuarin N. A. ka ekzistuar urdhëresa e lëshuar, e në rastin konkret i akuzuari B. B. është bashkëkryerës së bashku me të akuzuarin N. A., atëherë urdhëresa në fjalë vlen edhe për të akuzuarin B. B.. Andaj, edhe është mendimi i gjykatës që provat e siguruara nga këto masa janë të ligjshme dhe të vlefshme edhe për të akuzuarin B. B.

Duke marr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, N. A., D. B., M. S. i cili pranim është bërë konform nenit 326 par.1 lidhur me nenin 248 të KPP, pasiqë të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve me mbrojtësit e tyre, gjithashtu pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime teknike, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve të lartëcekur formohen elementet qenësore të veprës penale të marrjes së rryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KP.Ndërsa pas administrimit të provave sa i përket të akuzuarit B. B. gjykata ka vërtetuar se edhe në veprimet e të njëjtit formohen elementet qenësore të veprës penale të marrjes së rryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KP pasiqë të njëjtit në vazhdimësi në intervale kohore të ndryshme prej datës 15.08.2016 e deri më datën 10.11.2016 në bashkëveprim mes vehte në cilësinë e personave zyrtar – policëve të trafikut rrugor rregjional në Prizren, në mënyrë të drejtëpërdrejtë kërkojnë dhe marrin për vehte rryshfet në të holla, duke vepruar në kuadër të autorizimeve zyrtare, ndërmarrin veprime në kundërshtim me Ligjin e komunikacionit rrugor, në atë mënyrë që gjatë patrullimit në mirëvajtjen e komunikacionit, me automjetin zyrtar të policisë së markës “Shkoda” me targa të regjistrimit xxx-xx të akuzuarit N. dhe D. më datën 15.08.2016 pasi ndalin në një pikë kontrolli në aksin rrugor në Duhël, kundërvajtësen A. B. e cila drejtonte automjetin e markës “Mercedes” me targa të Suedisë, i marrin shumën e të hollave prej 70 Euro, në vend që ti lëshojnë tiketë për shqiptimin e gjobës për kundërvajtjen e kryer,

më datën 24.09.2016 i akuzuari N. nga kundërvajtësi me emrin G. merr shumën prej 20 Euro, ndërsa nga kundërvajtësi me emrin N. i merr shumën prej 50 Euro, në vend të shqiptimit të gjobës për kundërvajtjen e kryer,

më datën 09.09.2016 të akuzuarit N. dhe D. pasi ndalin në rrugë me automjet kundërvajtësin – shtetasin e Sllovakisë, nga ai kërkojnë dhe marrin shumën prej 100 Euro, në vend të shqiptimit të gjobës për kundërvajtjen e kryer,

më datën 03.10.2016 i akuzuari N. dhe B. nga kundërvajtësi me emrin B. marrin shumën prej 20 Euro, nga kundërvajtësi me emrin N. marrin shumën prej 20 Euro, në vend që ti shqiptojnë dënim me gjobë për kundërvajtje,ndërsa më datën 04.10.2016 nga kundërvajtësi me emrin A. marrin shumën prej 10 Euro për të mos i shqiptuar gjobë për kundërvajtjen e kryer,

më datën 19.10.2016 të akuzuarit D. dhe M. pasi ndalin në rrugë një kundërvajtës nga Shkupi, shtetas shqiptar nga i njëjti marrin shumën prej 10 Euro në vend të shqiptimit të gjobës për kundërvajtjen e kryer,

më datën 05.11.2016 i akuzuari N. pasi ndal në rrugë kundërvajtësin e paidentifikuar nga i njëjti merr shumën prej 10 Euro, më datën 10.11.2016 të akuzuarit M. dhe N. pasi që ndalin një kundërvajtës të paidentifikuar i cili me të akuzuarit komunikon në gjuhën serbe, nga i njëjti marrin shumën prej 10 Euro në vend të shqiptimit të dënimit me gjobë për kundërvajtjen e kryer.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 73 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë,motivet nga të cilat është kryer vepra, prej rrethanave lehtësuese gjykata morri parasysh qëndrimin korrekt të tyre, se janë persona familjar – të martuar dhe kanë fëmij, se është hera e parë që bienë në konflikt me ligjin, ndërsa sa i përket të akuzuarve N. A., D. B. dhe M. S. si rrethanë lehtësuese morri parasysh edhe pranimin e fajësisë. Ndërsa prej rrethanave rënduese peshën dhe natyrën e veprës së kryer penale,motivin



e kryerjes së veprës penale-që është për përfitime personale.Andaj, është mendimi i gjykatës që dënimet e shqiptuara do ta arrijnë qëllimin e vet konformë nenit 41 të KP, se dënimet e shqiptuara janë në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se do të mundësojnë një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarve ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale. Gjykata është e mendimit se dënimet e shqiptuara të akuzuarve janë në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaqërisht të asaj të posaçme, se do të ndikojnë në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këto dënime do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KP në të gjitha segmentet e tij. Dënimet e shqiptuara për kah lloji dhe lartësia janë në harmoni me rrethanat e rastit, të nevojshme dhe të mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit konform dispozitës së lartëcekur. Dënimet e shqiptuara të akuzuarve sipas gjetjes së gjykatës janë në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe se kur të mirret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, dënimet e këtilla paraqiten si të domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.1. të KPP.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**Më dt.10.12.2018, PKR.nr.30/18**

**Proçesmbajtësja**  
**Sheqere Braha**

**Kryetarja e trupit gjykues**  
**Ajser Skenderi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, **Gjykatës së Apelit në Prishtinë**, nëpërmjet të kësaj gjykate.